



UDHËZUES MBI HAPAT QË DUHEN NDJEKUR PËR TË FITUAR TITULLIN PROFESIONAL AVOKAT



Përmbajtja

| | | |
|-------|--|----|
| I. | Hyrje | 6 |
| 1.1 | Objektivat..... | 8 |
| 1.1.1 | Objektivi i përgjithshëm: | 8 |
| II. | Rruga e kualifikimit për titullin ‘Avokat’. Trajnimi fillestar i kandidatëve për avokat | 10 |
| 2.1 | Çfarë hapash duhen ndjekur për t’u regjistruar në Shkollën e Avokatisë dhe për të ushtruar profesionin e Avokatit?..... | 10 |
| 2.2 | Rregullorja e Shkollës së Avokatisë dhe detyrimet për studentët me qëllim përfundimin me sukses të studimeve | 12 |
| 2.2.1 | Shkolla e Avokatisë | 12 |
| 2.2.2 | Kushtet për regjistrimin fillestar | 13 |
| 2.2.3 | Procedura e regjistrimit..... | 13 |
| 2.2.4 | Përzgjedhja e kandidatëve..... | 14 |
| 2.2.5 | Vlerësimi i kandidaturave | 14 |
| 2.2.6 | Organizimi i procesit mësimdhënës | 14 |
| 2.2.7 | Rastet për përjashtimin nga hkolla..... | 14 |
| 2.2.8 | Përjashtimi nga detyrimi për ndjekjen e shkollës | 15 |
| III. | Kompetenca profesionale e nevojshme në momentin e fitimit të titullit profesional ‘Avokat’ / Standardi për të aksesuar profesionin | 17 |
| 3.1 | <i>Standardi (minimal) i nivelit të njohurive ligjore, aftësive dhe karakteristika të tjera:</i> | 18 |

| | | |
|--|--|----|
| 3.2 | Standardi (minimal) i aftësive praktike dhe karakteristikave dalluese të avokatit: | 19 |
| 3.3 | Advokimi/Mbrojtja: | 20 |
| 3.4 | Standardet profesionale:..... | 20 |
| 3.5 | Puna me të tjerët:..... | 20 |
| 3.6 | Menaxhimi i ushtrimit të profesionit: | 20 |
| IV. Programi mësimor i trajnimit fillestar në shkollën e avokatisë ... | | 22 |
| 4.1 | Objektivat në përgjithësi të trajnimit në auditor të kurseve/moduleve | 22 |
| 4.1.1 | | 22 |
| 4.1.2 | | 22 |
| 4.1.3 | | 22 |
| 4.1.4 | | 23 |
| 4.2 | Lënda e Drejta Private (pjesa e parë dhe pjesa e dytë). | 23 |
| 4.2.1 | Objektivat që synojnë të arrihen përmes lëndës , ‘E Drejta Private‘ (pjesa e parë dhe e dytë)..... | 24 |
| 4.2.2 | Temat/çështjet kryesore që trajtohen në lëndën E Drejta Private (pjesa e parë)..... | 25 |
| 4.2.3 | Burimet referuese | 25 |
| 4.2.4 | Temat / çështjet kryesore që trajtohen në lëndën E Drejta Private (pjesa e dytë)..... | 27 |
| 4.2.5 | Burimet referuese | 28 |
| 4.3 | E Drejta Procedurale Civile | 33 |
| 4.3.1 | Objektivat e lëndës/kursit..... | 33 |
| 4.3.2 | Temat / çështjet kryesore | 34 |
| 4.3.3 | Burimet referuese | 34 |
| 4.3.4 | Metodologjia | 35 |
| 4.3.5 | Testimi i njohurive | 36 |
| 4.4 | E Drejta Penale (pjesa e përgjithshme dhe e posaçme)..... | 37 |

| | | |
|-------|--|----|
| 4.4.1 | Objektivat e lëndës:..... | 37 |
| 4.4.2 | Temat/çështjet kryesore | 37 |
| 4.4.3 | Burimet referuese | 38 |
| 4.4.4 | Metodologjia | 39 |
| 4.4.5 | Testimi i njohurive | 40 |
| 4.5 | E Drejta e Procedurës Penale | 41 |
| 4.5.1 | Objektivat e lëndës/kursit..... | 41 |
| 4.5.2 | Temat kryesore..... | 41 |
| 4.5.3 | Burimet referuese | 42 |
| 4.5.4 | Metodologjia | 44 |
| 4.5.5 | Testimi i njohurive | 44 |
| 4.6 | E Drejta Publike | 45 |
| 4.6.1 | Objektivat e temave në fushën së drejtës kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut | 46 |
| 4.6.2 | Temat kryesore..... | 47 |
| 4.6.3 | Burimet referuese | 47 |
| 4.6.4 | Objektivat e temave në fushën e së drejtës administrative | 49 |
| 4.6.5 | Temat kryesore..... | 50 |
| 4.6.6 | Burimet referuese | 50 |
| 4.6.7 | Metodologjia | 51 |
| 4.6.8 | Testimi i njohurive | 52 |
| 4.7 | Përgatitje profesionale..... | 55 |
| 4.7.1 | Objektivat e trajnimit në disiplinën e deontologjisë dhe etikes profesionale | 55 |
| 4.7.2 | Temat kryesore..... | 55 |
| 4.7.3 | Burimet referuese | 56 |
| 4.7.4 | Metodologjia | 57 |
| 4.7.5 | Testimi i njohurive | 58 |

| | | |
|-------|---|----|
| 4.7.6 | Objektivat e trajnimit në disiplinën e Teknikave të Avokatisë | 58 |
| 4.7.7 | Temat kryesore..... | 58 |
| 4.7.8 | Metodologjia | 59 |
| 4.7.9 | Testimi i njohurive | 59 |
| 4.8 | Objektivat e trajnimit në disiplinën e shkrimit dhe arsyetimit ligjor | 59 |
| 4.8.1 | Temat kryesore..... | 59 |
| 4.8.2 | Burimet referuese | 60 |
| 4.8.3 | Metodologjia | 61 |
| 4.8.4 | Testimi i njohurive | 61 |
| V. | Testimi/provimi për fitimin e titullit avokat..... | 62 |
| 5.1 | Rregullat për regjistrimin në provimin për fitimin e titullit avokat 62 | |
| 5.2 | Struktura e provimit (pyetjet, kohëzgjatja e tjera) | 63 |
| 5.3 | Datat e provimeve | 63 |
| 5.4 | Mënyra e vlerësimit dhe pikët minimale për kalimin e provimit të avokatisë..... | 64 |
| 5.5 | Procedura ankimore | 64 |
| VI. | Kriteret për ushtrimin e profesionit të avokatit..... | 65 |
| 6.1 | Hapat që ndiqen për hapjen dhe regjistrimin e një zyre avokatie | 65 |
| 6.2 | Detyrimet tatimore të avokatëve dhe çështje financiare të rëndësishme..... | 66 |
| 6.3 | Etika profesionale dhe procesi disiplinor ndaj avokateve.. | 68 |
| 6.3.1 | Strukturat e masave disiplinore të avokatëve dhe procesi disiplinor..... | 70 |
| 6.3.2 | Hapat që ndjek ankesa kundër avokatit në DHKA | 71 |
| | ANEKSE:..... | 80 |

| | |
|---|----|
| 1. Dokumentat e regjistrimit per asistent avokat: | 80 |
| 2. Formular aplikimi për ndjekjen e trajnimit fillestar ne Shkollën Kombëtare te Avokatisë..... | 81 |
| 3. Kërkesa për hapjen e zyrës së avokatisë së bashku me dokumentacionin shoqërues tip të miratuar nga KP i DHKA..... | 83 |
| 4. Formular Ankese ndaj një avokati dhe formatet tip të procedimit | 84 |

I. Hyrje

Kompetenca profesionale është një nga parimet themelore të profesionit ligjor, siç është e përcaktuar në "Kartën e parimeve themelore të CCBE/Këshilli i Bareve dhe Shoqatave Ligjore në Evropë", në Rekomandimin të Këshillit të Evropës mbi lirinë e ushtrimit të profesionit ligjor¹, në "Rezolutën e Parlamentit Evropian për profesionet ligjore dhe interesave të përgjithshme në funksionimin e sistemit ligjor", dhe "Parimet themelore mbi Rolin e Avokatëve" të Kombeve të Bashkuara.

Kjo kompetencë nuk mjaftohet vetëm në njohuritë e nevojshme mbi ligjin. Ushtrimi i profesionit të avokatit, i konsideruar vazhdimisht për të ndërmjetësuar mes universalitetit të normave dhe shumëllojshmërisë së rasteve, me qellim lidhjen e universale (normës) dhe të veçantës (çështjes), kërkon pjekuri, aftësi dhe ndjeshmëri që kapërcen njohurinë e thjeshtë të institucioneve dhe normave ligjore.

Me miratimin e Ligjit nr. 91/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", është përcaktuar, detyrimi i ndjekjes së programit të trajnimit nga kandidatët për avokatë si një nga parakushtet për ushtrimin e profesionit të avokatit¹, si dhe detyrimi i ndjekjes së programit të trajnimit vazhdues nga avokatët.² Për përgatitjen, organizimin dhe administrimin e programit të trajnimit fillestar për kandidatët për avokatë dhe programit të trajnimit vazhdues për avokatët, është ngritur dhe funksionon prej 5 vitesh, Shkolla Kombëtare e

¹ Neni 25 të ligjit nr. 9109/2003.

² Neni 16/1 të ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

Avokatisë, si organ i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.³Këto ndryshime i shërbejnë, veçanërisht rritjes së profesionalizmit të personave që kërkojnë të ushtrojnë profesionin e avokatit, duke rritur jo vetëm cilësinë e shërbimit, por edhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë që ka për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ushtrimin korrekt dhe në përputhje me ligjin dhe rregullat e etikës të profesionit të avokatit.

Përgatitja e këtij udhëzuesi mbi hapat që duhen ndjekur për të fituar titullin profesional avokat është rezultat i konsultimeve të gjera dhe reflektimit të bëra në bazë të përvojës së fituar gjatë 5-viteve të fundit, së pari në kuadër të ngritjes së sistemit të edukimit profesional vazhdues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, dhe në Shkollën Kombëtare të Avokatisë, si strukturë e Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Ky udhëzues është draftuar duke pasur në konsideratë kryesisht dallimin midis arsimit universitar dhe trajnimit profesional me synim përkufizimin/përcaktimin e standardeve (minimale) mbi njohuritë, aftësitë si dhe karakteristika dalluese për të qenë i denjë për të ushtruar profesionin e avokatit.

Është e rëndësishme të theksohet së Udhëzuesi është konceptuar si një dokument fleksibel i cili do të pasurohet në vazhdimësi me amendimet ligjore/literaturën e fundit për t'i shërbyer në këtë mënyrë kryesisht studenteve të Shkollës së Avokatisë, por jo vetëm dhe për këtë arsye do të publikohet në një format on-line lehtësisht të aksesueshëm prej tyre në website të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

³ Shih, paragrafin 4 të nenit 25/1 të ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

1.1 Objektivat

1.1.1 Objektivi i përgjithshëm:

Udhëzuesi ka për qëllim të shërbejë së pari, si një udhërrëfyes i hapave ligjore dhe praktike që duhen ndjekur nga juristet apo më mire asistent avokatët e regjistruar në DHKA/Shkollën Kombëtare të Avokatisë për t'u bërë avokat dhe kryesisht t'i njohë ata me standardet e njohurive dhe aftësive që ata duhet të arrijnë/zotërojnë në përfundim të trajnimit fillestar, edhe me qëllim kalimin me sukses të provimit të avokatisë në ofrimin e shërbimeve ligjore cilësore ndaj publikut. Kalimi me sukses i provimit të avokatisë, si mendim i parë që i vjen ndërmend të gjithë asistent avokatëve, nuk duhet të jete arsyeja thelbësore e ndjekjes së Shkollës prej tyre, por duhet të shërbejë për plotësimin e kapacitetit të praktikës ligjore dhe pjekurisë së tyre profesionale.

Objektiva specifike:

- Njohja e procedurës dhe kostove përkatëse për juristet e rinj dhe asistent avokatët për t'u regjistruar në Shkollën e Avokatisë.
- Njohja e objektivave mësimore, temave kryesore, shembujve/kazuseve, metodologjisë së mësimdhënies dhe literaturës së nevojshme përpara fillimit të Shkollës;
- Përshkrimi i njohurive, aftësive si dhe karakteristikave të veçanta/dalluese që duhet të gëzojë një avokat në “ditën e parë të punës” – çfarë duhet të presin nga vetja dhe kolegët;
- Njohjen e avokatëve të rinj me çështje të organizimit dhe çështje financiare të lidhura me hapjen e zyrës së avokatisë;
- Njohjen e avokatëve të rinj me etikën profesionale si dhe procesin disiplinor ndaj avokatëve.

Kujt i drejtohet udhëzuesi:

- Asistent avokatëve të regjistruar pranë DHKA përpara procesit të regjistrimit të tyre në Shkollën Kombëtare të Avokatisë.
- Avokatëve të rinj përsa i takon standardeve profesionale që priten prej tyre apo që ata duhet të presin nga kolegët e tyre;
- Studentëve/Juristëve të rinj për të qënë të mirë informuar lidhur me vendimin për t'i hyre profesionit të avokatisë;
- Lektorëve/avokatëve të cilët do të përfshihen në programin e Trajnimit Fillestar të Shkollës Kombëtare të Avokatisë.
- Publikut në përgjithësi për t'u informuar mbi rolin profesional të avokatit.

**Per versionin e plote te ketij dokumenti
kontaktoni Dhomen Kombetare te Avokatise**

**email: info@dhka.org.al
telefon: +355 4 225 1876**